# V E N D I M
## Nr.339, datë 23.6.2000

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR" NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.516, DATË 14.11.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe të ministrit të Financave, Këshlli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.516, datë 14.11.1999, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 69.2 shtohet pika 69.3, me këtë përmbajtje:

"69.3 Çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar, për filmat kinematografikë të importuar në Republikën e Shqipërisë me të drejtën e riprodhimit dhe të shpërndarjes, nuk do t'i shtohen e drejta e pronësisë intelektuale (royalities) dhe e drejta e licensës (licence fee).".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Ilir Meta**